



Institute for Democracy and Mediation  
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Mbështetje për Parlamentin  
dhe Edukimin Qytetar në Shqipëri

# MODELI FUNKSIONAL I GRUPEVE VENDORE TË VEPRIMIT SIPAS QASJES LEADER

PËRGATITUR NGA **EVELINA AZIZAJ**,  
KOORDINATORE KOMBËTARE, RRJETI SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN RURAL

TETOR 2022



# PROBLEMATIKA

Komunitetet rurale në Shqipëri janë përballur me një sërë sfidash zhvillimore në dekadat e fundit të cilat nuk janë adresuar në mënyrë efektive nga politikat publike. Në mesin e shumë problemeve vlen të theksohet shpopullimi në masë të konsiderueshme, standardi i ulët i jetesës, perspektiva e kufizuar për të ardhmen në komunitetet rurale, veçanërisht për të rinjtë etj. Baza e shkaqeve për këto probleme është e gjerë dhe përfshin ndër të tjera kufizimet strukturore dhe sfidat në sektorin e bujqësisë, infrastrukturën publike sociale-ekonomike dhe shërbimet publike jo adekuate, politikat publike jo efektive, po aq edhe probleme që lidhen me mendësinë tradicionale.

- **Varfëria, pabarazia dhe përjashtimi social i komuniteteve rurale.** Varfëria përbën një nga pengesat kryesore për angazhimin e qytetarëve të zonave rurale në veprimtaritë vendore sociale, ekonomike dhe politike. Varfëria rurale është rritur ndër vite.
- **Pabarazia gjinore në zonat rurale.** Sipas të dhënave zyrtare gratë janë të disavantazuara ndaj burrave në lidhje me aksesin në tregun e punës. Megjithëse nga viti në vit përqindja e forcës aktive për punë në bujqësi ka rënë, shifra e punësimit të grave në këtë sektor vazhdon të jetë gjithnjë më e lartë se ajo e burrave, ndërsa pozicioni i grave rezulton të jetë më i dobët se ai i burrave, veçanërisht në lidhje me pronësinë mbi ndërmarrjet aktive bujqësore.
- **Të rinjtë në zonat rurale** përbëjnë gjithashtu, krahas grave, një prej grupeve të pafavorizuara. Aktualisht, pjesa më e madhe e të rinjve në zonat rurale konsiderojnë bujqësinë si jo atraktive, si pasojë e vështirësisë si profesion, aksesit të kufizuar në tregje, apo nivelit të ulët të të ardhurave.
- **Demokracia vendore.** Reforma Administrative Territoriale gjeneroi deficit demokratik në nivel vendor, në veçanti në zonat e thella rurale, për shkak të largësisë fizike të banorëve në zonat e largëta për të aksesuar proceset e vendimarrjes vendore si dhe nga mungesa e një shoqërie civile aktive.
- **Nevoja e qeverisjes territoriale për kohezion social-ekonomik të komuniteteve vendore.** Politikat e bazuara tek territori janë të domosdoshme në kontekstin vendor shqiptar të pas reformës administrative territoriale, e cila nuk mundi të gjenerojnë efektet e dëshiruara në drejtim të zhvillimit të integruar të territorit të 61 bashkitë e vendit.
- **Mungesa e politikave të zhvillimit rural në politikat publike të sektorit të zhvillimit bujqësor dhe rural** përbën edhe një nga boshllëqet me pajtueshmërinë me Politikën e Përbashkët Bujqësore (CAP). Politikat e zhvillimit rural ende nuk janë të qarta, pavarësisht ndërmarrjes së programeve të ndryshme siç është ai i 100 fshatrave. Në këtë aspekt, Shqipëria mbetet prapa përse i përket promovimit të zhvillimit vendor të udhëhequr nga komuniteti ose qasjes Leader<sup>1</sup> (si instrument të CAP) për zhvillimin e integruar të komuniteteve rurale.

1 Leader është akronim që rrjedh nga fjalia në frëngjisht “Liaison Entre Actions de Développement de l’Économie Rurale”, që do të thotë “Lidhjet ndërmjet ekonomisë rurale dhe veprimeve zhvillimore”.

E konsideruar një histori suksesi në zhvillimin rural në vendet e Bashkimit Evropian (BE), qasja LEADER ka potencialin të shndërrohet edhe për Shqipërinë në një instrument shumë të rëndësishëm për fuqizimin e komuniteteve lokale dhe orientimin e tyre drejt një zhvillimi të integruar. Ndërsa përpjekjet për zbatimin e qasjes LEADER në vendin tonë janë relativisht të hershme edhe pse të pashoqëruara me mbështetje të qëndrueshme në kohë, veçoritë e zhvillimit të përgjithshëm socio-ekonomik të vendit e evidentojnë atë si faktor thelbësor në përmirësimin e jetesës së komuniteteve rurale, zbutjen e varfërisë, reduktimin e pabarazive gjinore e territoriale si dhe forcimin e kapitalit social dhe demokracisë vendore. Inkurajimi i qasjes nga poshtë lart dhe ndikimi i zbatimit të qasjes LEADER (nëpërmjet konceptit të tripartitetit) në përmirësimin e besimit, bashkëpunimit dhe vendimarrjes midis aktorëve publikë dhe jo publikë i jep mundësi zonave rurale të jenë përcaktuese të politikave të tyre zhvillimore në periudhën afatgjatë.

Zbatimi i qasjes Leader në frymën që e kërkon ky instrument nuk është i lehtë dhe mbi të gjitha, krijimi i partneriteteve në formën e Grupeve Vendore të Veprimit (GVV) kërkon kohë të mjaftueshme, besim të ndërsjelltë ndërmjet aktorëve dhe leadership vendor. Proceset e tipit Leader kanë gjasa të shoqërohen me risqe të ndryshme, si për shembull dominimi i procesit nga qeverisja lokale dhe GVV-ja të shihet si zgjatim i bashkive. Zbatimi i qasjes Leader është proces sfidues, edhe më sfidues në komunitetet shqiptare që karakterizohen nga kapital i ulët social dhe besueshmëri e ulët ndërmjet institucioneve dhe aktorëve të tjerë vendor.

Nxitja e proceseve vendore të tipit Leader nga poshtë lart kanë nevojë për inkurajim dhe mbështetje nga lart poshtë. Aktorët vendor para se të përfshihen në këto procese, duhet të kenë njohuri dhe kapacitete për të zbatuar qasjen Leader, krijimin e partneriteteve, mobilizimin e komuniteteve, hartimin e strategjive vendore etj. Udhëheqja, mentorimi dhe orientimi i aktorëve të ndryshëm në zbatimin praktik të kësaj qasje janë të rëndësishme për të shmangur risqet dhe formalizmin në këto zhvillime, si dhe mbivendosjen e nismave të ndryshme në të njëjtin territor, të cilat veç rrisin konfuzionin e aktorëve vendorë dhe jo-efektivitetin e përdorimit të mbështetjes financiare nga burime të ndryshme.

## KUADRI LIGJOR DHE STRATEGJIK

Ligji Nr. 36/2022 “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit” lehtëson zbatimin e zhvillimit vendor të udhëhequr nga komuniteti – instrumentin e Politikës së Përbashkët Bujqësore të BE-së për zhvillimin e integruar rural, i njohur ndryshe si qasja Leader. Kjo filozofi dhe instrument zhvillimi synon të mobilizojë dhe të lidh energjinë dhe burimet e njerëzve si dhe organizatave për të inkurajuar partneritet në nivel nënrajonal ndërmjet tre sektorëve, atij publik, privat dhe civil. Ligji përcakton parakushtet për krijimin dhe funksionimin e GVV-ve.

Ligji Nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”. GVV-të duhen të regjistrohen si organizata jo-qeveritare me anëtarësi<sup>2</sup>, por duke përmbushur kërkesat që

2 Ligji Nr. 36/2022 “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit”, neni 10/1.

Ligji Nr. 36/2022 kërkon për strukturën, mënyrën e funksionimit dhe vendimmarrjes apo të tjera detyrime ligjore të GVV-ve. GVV-ja është strukturë partneriteti dhe asnjë sektor nuk dominon vendimmarrjen.<sup>3</sup>

Ligji Nr.9817, datë 22.10.2007 “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”përcakton masën “Mbështetja për ndërmarrjen e nismave vendore”. Mbështetja stimulon nismat, që përfshijnë fermerët, punonjësit e pyjeve dhe aktorët e tjerë ruralë, të cilët mund të ruajnë dhe të rrisin më tej trashëgiminë vendore, natyrore dhe kulturore, të rrisin ndërgjegjësimin mjedisor dhe të promovojnë produktet tipike, turizmin dhe burimet e rinovueshme të energjisë.<sup>4</sup>

Programi IPARD III, masa 5 Zbatimi i strategjive lokale të zhvillimit – qasja Leader do të mbështesë në vlerën 4.8 milion Euro këtë qasje duke mundësuar kështu zhvillimin lokal të udhëhequr nga komuniteti si dhe duke u frymëzuar nga historia e suksesshme e zbatimit të qasjes Leader në Evropë.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) është Ministria përgjegjëse për krijimin, përditësimin e kuadrit rregullator si dhe struktura që planifikon, zbaton dhe monitoron masën e qasjes Leader në IPARD III, si dhe në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit (2021-2027). GVV-të do të raportojnë për veprimtarinë e tyre pranë strukturës përgjegjëse në MBZHR, në baza vjetore.<sup>5</sup>

## REKOMANDIME

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të luajë **rolin katalizues në mobilizimin e asistencës nga donatorë të ndryshëm për të përgatitur terrenin e duhur për zbatimin e qasjes**, duke përfshirë informimin, ndërtimin e kapaciteteve të gjithë aktorëve të interesit, asistencën teknike dhe infrastrukturën e duhur që mbështet zbatimin e suksesshëm të qasjes Leader, duke përfshirë zbatimin efektiv të ligjit dhe rrjedhimisht masës Leader të përfshirë në IPARD III. Procese të hapura, transparente dhe gjithëpërfshirëse që lehtësojnë shkëmbimin e informacionit dhe koordinojnë aktorët të angazhuar në nivele të ndryshme duhet të nxiten dhe të mbahen të qëndrueshme nga MBZHR

Është e nevojshme **nxitja e një sipërmarrje kombëtare përsa i përket zbatimit të qasjes LEADER/ CLLD** jo vetëm si detyrim në kuadër të IPARD II, por mbi të gjitha si një investim për një zhvillim të qëndrueshëm të vendit dhe forcimin e demokracisë vendore. Për këtë është jetike **komplementariteti i përpjekjeve të MBZHR me kapacitetet dhe potencialin që ofrojnë aktorë të tjerë**, në mënyrë të vecantë shoqëria civile. Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural - një rrjet kombëtar i ngritur bazuar në vet parimet e qasjes Leader ofron mbështetje teknike për Leader, forume të shkëmbimit të njohurive dhe praktikave, hapësira rrjetëzuese për GVV-të etj. Ky bashkëpunim do të lehtësojë krijimin e modeleve

3 Ligji Nr. 36/2022 “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit”neni 5/2.

4 Ligji Nr.9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, neni 19.

5 Ligji Nr. 36/2022 “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit” Neni 17/pika 1.

dhe praktikave pozitive në zhvillimin e udhëhequr nga komuniteti, përmes përgatitjes së terrenit të duhur për zbatimin efektiv të ligjit dhe si rrjedhim të filozofisë evropiane Leader për zhvillimin e integruar vendor.

ANRD synon të lancojë **Akademine e Zhvillimit të Integruar vendor "LEADER" si qendër burimore për filozofinë e zhvillimit vendor të udhëhequr nga komuniteti**. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ftohet të angazhohet bashkërisht në realizimin e Akademisë duke bashkëpunuar dhe koordinuar me donatorë të përfshirë në mbështetjen e sektorit rural dhe bujqësor. Akademia do të përfshijë module trajnimi mbi ngritjen e kapaciteteve për aktorët e interesit (Njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucione të tjera publike, organizatat e shoqërisë civile, sipërmarrjen dhe sektorin e biznesit etj.), ëorkshope tematike, asistencë teknike për zhvillimin e strategjive të zhvillimit lokal, projekteve, dhe aktivitete të tjera shkëmbyese dhe rrjetëzuese për Leader. Akademia do të lehtësojë dhe strukturojë ofrimin e njohurive dhe përvojën nga vende të tjera evropiane (si për shembull Italia, Sllovenia dhe Kroacia) në zbatimin e këtij instrumenti të zhvillimit vendor.

Është kritike **mobilizimi i vullnetit politik që priorizon, mbështet dhe nxit zbatimin e qasjes LEADER në Shqipëri**. Bashkëpunimi me Komisionin Parlamentar të Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit është i rëndësishëm për të siguruar kontrollin postlegjislativ dhe për të operacionalizuar zbatimin e parashikimeve ligjore për këtë qasje dhe ndërgjegjësimin mbi risqe të mundshme që shoqërojnë zbatimin e nismave vendore të qasjes Leader. ANRD dhe aktorë të tjerë të sektorit publik dhe jo-publik duhet të rrisin angazhimin e tyre në proceset parlamentare për përgjegjshmëri të përmirësuar të institucioneve dhe strukturave përgjegjëse për zbatimin e qasjes Leader në Shqipëri.



*Ky dokument prezanton një përmbledhje të analizave, gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore të punës të Rrjetit Shqiptar të Zhvillimit Rural përsa i përket punës tematike me qasjen Leader në pesë vitet e fundit (2018-2022). Dokumentat e shqyrtuar janë si më poshtë:*

*Hroni, S., & Azizaj, E., (2018). Komentar. Qasja Leader dhe programi i 100 fshatrave – Një perspektivë plotësuese dhe sinergjike për zhvillimin e integruar të zonave rurale. E disponueshme tek: <https://anrd.al/publikime>*

*Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural (2018). Letër Pozicionimi mbi Qeverisjen e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. E disponueshme tek: <https://anrd.al/publikime>*

*Muça (Dashi), E. & Azizaj, E., & Totoni, L. (2020). Dokument Politikash. Dinamikat e zbatimit të qasjes LEADER në Shqipëri dhe e ardhmja. E disponueshme tek: <https://anrd.al/publikime>*


*Azizaj, E. (2021). BLOG – Evropa në Shqipërinë rurale, dritë jeshile për zbatimin e instrumentit të politikës evropiane të zhvillimit rural në Shqipëri. E disponueshme tek: <https://anrd.al/publikime>*

*Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural (2022). Rezolutë. Rilindja e komuniteteve rurale përmes jetësimit të qasjes LEADER në Shqipëri: Akademia e zhvillimit të integruar vendor “LEADER” – domosdoshmëri për të garantuar suksesin e zbatimit të zhvillimit vendor të udhëhequr nga komuniteti. E disponueshme tek: <https://anrd.al/publikime>*



Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim — IDM është një organizatë jo- qeveritare, e themeluar në nëntor të vitit 1999, që ka në fokus të veprimtarisë së vet qeverisjen pjesëmarrëse dhe institucionet demokratike, procesin e integritimit në Bashkimin Evropian, zhvillimin e shoqërisë civile, bashkëpunimin rajonal dhe çështjet e sigurisë. Ne synojmë konsolidimin e zhvillimeve në këto fusha nëpërmjet hulumtimit të pavarur, rritjes së kapaciteteve dhe ndërveprimeve efikase përmes spektrit të gjerë të aktorëve në shoqëri.

Projekt i:



Zbatuar nga:



Shënim: Pikëpamjet dhe përfundimet që jepen në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe të NDI – Institutit Demokratik Amerikan. Autorësia e këtij botimi i përket vetëm IDM-së.